

RAPORT

Korrik – Shtator 2025



FUSHË KOSOVË,
Tetor 2025

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	3
II.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK-TRAINKOS SH. A.	4
III.	TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR	5
III.1	Gjendja financiare Korrik – Shtator 2025	5
III.1.1	Të hyrat	5
III.1.2	Shpenzimet	6
III.2	Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 30.09.2025	12
III.3	Transaksionet e realizuara (Korrik – Shtator 2025)	12
III.4	Bilanci i gjendjes (30.09.2025).....	14
IV.	TRANSPORTI I UDHËTARËVE	15
IV.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU	15
IV.2	Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km)	16
IV.3	Vonesat e trenave të udhëtarëve	16
V.	TRANSPORTI I MALLRAVE	17
V.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TM	17
V.2	Shfrytëzimi i trenave	20
V.3	Efektiviteti i trenave	20
V.4	Neto-ton & neto-ton-kilometër të transportuar	20
V.5	Revokimi i trenave	21
VI.	MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE – MML	22
VI.1	Pasqyra e performancës operative	22
VI.2	Spektori i Mirëmbajtjes.....	22
VI.3	Mirëmbajtja e trenave motorikë.....	22
VI.4	Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese.....	22
VI.5	Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese.....	23
VI.6	Intervenimet në mjetet tërheqëse.....	23
VI.7	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve.....	23
VI.8	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave.....	24
VI.9	Riparimi i vagonëve të huaj.....	24
VII.	PROJEKTET DHE PROKURIMI.....	25
VII.1	Projektet kapitale	25
VIII.	KONTESTET LIGJORE.....	30
VIII.1	Kontestet ligjore për vitin 2025	30
IX.	AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT	31
IX.1	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit.....	31
IX.2	Aktivitetet në transportin e mallrave.....	31
IX.3	Aktivitetet në fushën promovuese.....	32
IX.4	Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera.....	32
IX.5	Pjesëmarrja e HK-Trainkos Sh.A. në iniciativat e BE-së.....	33
IX.6	Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante.....	33
X.	Sfidat kryesore gjatë periudhës Korrik – Shtator 2025 dhe veprimet për të ardhmen.....	34

I. HYRJE

Raporti për periudhën Korrik – Shtator 2025, për HK-Trainkos Sh.A., është karakterizuar kryesisht më përpjekjen e të gjitha niveleve organizative të Ndërmarrjes duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri te stafi ekzekutiv për arritjen e rezultateve më pozitive në kushtet dhe mundësitë ekzistuese.

Ky raport paraqet aktivitetet gjatë këtij tre mujori (Korrik – Shtator 2025) në funksion të arritjes së objektivave të vendosura me Planin e Biznesit. Po ashtu, në këtë raport pasqyrohen vështirësitë dhe sfidat gjatë zhvillimit të aktivitetit të Ndërmarrjes për këtë tremujor, sfida këto që përcillen nga periudhat paraprake e që ndikojnë drejtpërdrejt në (mos) arritjen e planifikimeve.

Sfidat për këtë periudhë kanë qenë nga më të ndryshmet, duke u përballur me të gjitha vështirësitë që vijnë nga mungesa e kërkesës në treg, veçanërisht atyre të transportit të mallrave nga shkaku i mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore. Mbyllja e kësaj linje ka pamundësuar zhvillimin e transportit ndërkombëtar dhe transportin e brendshëm të mallrave. Newco Ferronikeli, si klienti ynë kryesor, edhe pse ishte zotuar për transport të brendshëm të mallrave, kjo nuk është realizuar.

Transporti i udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Pejë dhe anasjelltas vazhdon të bëhet me shumë vështirësi, kjo për shkak të vjetërsisë dhe gjendjes jo të mirë të mjeteve tërheqëse dhe të tërhequra.

Sa i përket transportit të udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Shkup - Prishtinë (Maqedoni e Veriut) treni ende nuk është lëshuar në qarkullim për shkak punimeve që janë duke u zhvilluar në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, Fushë Kosovë – Hani i Elezit. Kjo ndërprerje e qarkullimit do të vazhdojë deri në rehabilitimin e plotë të këtij segmenti hekurudhor.

Pavarësisht vështirësive të paraqitura, HK-Trainkos Sh.A. ka vazhduar përpjekjet për të menaxhuar situatën dhe për të siguruar funksionimin e proceseve të brendshme në përputhje me mundësitë e kufizuara. Megjithatë, ndikimi i faktorëve të jashtëm, përfshirë ndërprerjet e linjave hekurudhore dhe mungesa e kërkesës për transport mallrash, ka bërë të pamundur realizimin e objektivave të Planit të Biznesit për këtë periudhë.

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH.A.

Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK - Trainkos - SH.A është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK - Trainkos - SH.A. më 01 Korrik 2025 dhe më 30 Shtator 2025				
Totali i të punësuarve	01.07.2025		30.09.2025	
	160		146	
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje	
Datat	01.07.2025	30.09.2025	01.07.2025	30.09.2025
Mosha mesatare e punëtorëve	48.27 %	48.65 %	%	%
Në marrëdhënie të rregullt pune	160	146	%	%
Meshkuj	136	126	85 %	86.30 %
Femra	24	20	15 %	13.69 %
Serbë	1	1	0.62 %	0.68 %
Shqiptarë	159	145	99.37 %	99.31 %
Me shkollim fillor	2	2	1.25 %	1.36 %
Me PM (përgatitje të mesme) shkollore	84	76	52.5 %	52.05 %
Me kualifikim profesional	20	20	12.5 %	13.69 %
Me përgatitje të lartë	2	2	1.25 %	1.36 %
Me përgatitje superiore	52	46	32.5 %	31.50 %
Zyrtarët e Lartë	3	4	1.87 %	2.73 %
Departamenti për Operime Hekurudhore	95	90	59.37 %	61.64 %
Departamenti i Administratës	33	29	20.62 %	19.86 %
Departamenti i Financave	4	3	2.5 %	2.05 %
Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim të Biznesit	11	8	6.87 %	5.47 %
Kabineti i KE-së	2	2	1.25 %	1.36 %
Zyra e Prokurimit	2	2	1.25 %	1.36 %
Njësia e Auditimit të Brendshëm	1	1	0.62 %	0.68 %
Spektori i Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	9	7	5.62 %	4.79 %

Vërejtje: Në tabelën e cekur më lartë nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Gjatë tremujorit Korrik - Shtator 2025 në Ndërmarrje ka pasur disa lëvizje/ndryshime të stafit në numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

Nr.	Emërtimi	Korrik	Gusht	Shtator
1	Aktiv në fillimmuaj	160	153	149
2	Të pensionuar	2	3	0
3	Të larguar/shkarkuar	1	0	0
4	Të dorëhequr	4	2	3
5	Të punësuar	0	1	0
6	Frekuenca në fundmuaj	160	154	149
7	Aktiv në fundmuaj	153	149	146

Në bazë të të dhënave në tabelën me lart, shihet se numri i përgjithshëm i punëtorëve më datën 01.07.2025 kanë qenë 160, ndërsa me datën 30.09.2025 kanë qenë 146 punëtorë.

III. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. Gjendja financiare Korrik – Shtator 2025
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (30.09.2025)
3. Transaksionet e realizuara (Korrik - Shtator 2025)
4. Bilanci i Gjendjes (30.09.2025)

III. 1 Gjendja financiare Korrik – Shtator 2025

Për periudhën raportuese Korrik – Shtator 2025, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

III. 1.1. Të hyrat

Gjatë periudhës Korrik – Shtator 2025 nga **transporti i mallrave** nuk kemi realizuar të hyra. Totali i të hyrave të planifikuara nga transporti i mallrave për këtë periudhë raportuese ka qenë 250,000.00€, e cila nuk është realizuar për arsye që linja e 10-të ende qëndron e mbyllur, gjithashtu edhe klienti ynë kryesor Newco Ferronikel nuk është duke realizuar të hyra nga transporti i brendshëm.

Transporti i udhëtarëve për periudhën Korrik – Shtator 2025 është realizuar në shumën totale prej 402,747.82€. Prej këtyre të hyrave, nga transporti i kontraktuar me MMPHI për OSHP janë realizuar 253,361.37€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesës së humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve nga ME janë realizuar 128,650.02€, ndërsa të hyrat nga biletat janë realizuar në shumën prej 20,736.43€.

Totali i të hyrave të planifikuara nga transporti i udhëtarëve për këtë periudhë raportuese ka qenë 495,068.75€, realizimi i të cilave është arritur në shkallën prej 81.35%.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës Korrik – Shtator 2025 janë realizuar në shumën prej 357.40€. Kjo e hyrë është realizuar nga kontrata me kompaninë GCF në vlerë prej 357.40€ , ndërsa në pozicionin e të hyrave nga RIV-i dhe vendosje e vagonëve në binarë nuk kemi realizuar të hyra për këtë periudhë.

Të hyrat totale nga kjo kategori kanë qenë të planifikuara në shumën prej 7,500.00€, ndërsa realizimi i tyre është arritur në shkallën prej 4.76%.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës Korrik – Shtator 2025, kanë arritur shumën prej 8,928.52€. Këto të hyra janë realizuar në pozicionet si: të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh.A., në shumën prej 6,059.73€, të hyrat nga qiraja në shumën prej 2,542.37€, si dhe të ardhura nga interesi nga llogaria FLEX në vlerë prej 326.42€, ndërsa nga pozicioni i të hyrave nga shitjet tjera (riparimi i vagonëve) nuk kemi realizuar të hyra në këtë periudhë. Të hyrat nga kjo kategori, krahasuar me planifikimin prej 21,500.00€, janë realizuar në shkallën prej 41.52%.

III. 1.2. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën Korrik – Shtator 2025, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën raportuese është në shumën prej 58,490.87€. Planifikimi i këtyre shpenzimeve për TM3 ka qenë në shumën prej 305,375.00€ dhe arrin kuotën e realizimit në shkallën prej 19.15%.

Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Korrik – Shtator 2025.

Shpenzimet e stafit janë kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur realizimin në shumën prej 293,463.83€. Këto shpenzime kanë qenë për kategorinë paga dhe kontribute në vlerë prej 293,383.83€ dhe 80.00€ kanë qenë për trajnime apo shpenzime tjera. Në total, nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar (362,500.00€) për TM3 të vitit 2025, në këtë kategori kemi arritur kuotën e realizimit në shkallën prej 80.95%.

Totali i shpenzimeve operative arrin shumën prej 4,674.15€, e cila është realizuar në shkallën prej vetëm 17.92% nga shuma e planifikuar prej 26,075.00€ për TM3 - 2025. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Korrik – Shtator 2025.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 14.52%, konkretisht në shumën prej 4,218.95€. Planifikimi për këto shpenzime për TM3-2025 ka qenë në shumën prej 29,050.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Korrik – Shtator 2025:

Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Korrik – Shtator 2025


	EMËRTIMI	Planifikimi Korrik - Shtator 2025	Realizimi Korrik - Shtator 2025	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Korrik - Shtator 2024
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	250 000,00	-	250 000,00	-	-
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	325 000,00	253 361,37	71 638,63	77,96	244 104,78
3	TU – Ministria e Ekonomisë	152 568,75	128 650,02	23 918,73	84,32	152 568,75
4	TU – Shitja e Biletave	17 500,00	20 736,43	(3 236,43)	118,49	12 435,19
5	Shërbimet tjera	7 500,00	357,40	7 142,60	4,77	1 500,00
6	Të ardhurat nga riparimi i vagonëve të huaj	5 000,00	-	5 000,00	-	-
7	Të hyrat tjera jo operative	21 500,00	8 928,52	12 571,48	41,53	16 102,50
I	TOTAL – TË HYRAT	779 068,75	412 033,74	367 035,01	52,89	426 711,22
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	193 500,00	-	193 500,00	-	65 893,52
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	5 375,00	3 514,22	1 860,78	65,38	3 322,03
3	Inventar dhe pajisje	1 250,00	-	1 250,00	-	128,73
4	Material harxhues	250,00	-	250,00	-	-
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	15 000,00	-	15 000,00	-	13 020,66
6	Qasja në binarë	80 000,00	42 591,53	37 408,47	53,24	43 219,91
7	Sigurimi i palëve të treta	1 250,00	87,27	1 162,73	6,98	-
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	2 500,00	6 317,94	(3 817,94)	252,72	-
9	KMSH Nafta Infrakos	5 000,00	5 979,91	(979,91)	119,60	8 069,42
10	Servisimi i arkave fiskale	1 250,00	-	1 250,00	-	-
11	Zbritjet e lejuara	-	-	-	-	-
	TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT	305 375,00	58 490,87	246 884,13	19,15	133 654,27

	Fitimi (humbja) bruto	473 693,75	353 542,87	120 150,88	74,64	293 056,95
	TË ARDHURAT TJERA					
1	Të ardhurat e jashtëzakonshme	-	-	-	-	
2	Të hyrat e shtyra (shpenzimet)	-	-	-	-	
3	Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)	-	-	-	-	
4	Të ardhura tjera (shitja e skrapit-mbeturinat)	-	-	-	-	
	TOTAL – Të ardhurat tjera	-	-	-	#DIV/0!	-
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	361 250,00	293 383,83	67 866,17	81,21	340 318,83
2	Trajnime dhe shpenzime tjera	1 250,00	80,00	1 170,00	6,40	32,50
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	362 500,00	293 463,83	69 036,17	80,96	340 351,33
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	1 250,00	545,76	704,24	43,66	1 933,33
2	Shpenzimet logjistike	2 500,00	-	2 500,00	-	713,63
3	Energjia elektrike dhe komunali	1 750,00	1 414,39	335,61	80,82	60,00
4	Kontrollimet sistematike	750,00	250,00	500,00	33,33	-
5	Marketingu	2 250,00	50,00	2 200,00	2,22	84,75
6	Udhëtimet zyrtare	750,00	-	750,00	-	-
7	Telefonat dhe Posta	2 375,00	1 916,57	458,43	80,70	1 988,74
8	Shërbimet bankare	250,00	313,92	(63,92)	125,57	157,19
9	Tatimet	10 500,00	153,00	10 347,00	1,46	3 912,00
10	Pajisje elektronike	3 700,00	30,51	3 669,49	0,82	275,12
	TOTAL - Shpenzimet operative	26 075,00	4 674,15	21 400,85	17,93	9 124,76
E	Shpenzimet administrative					
1	Inventar dhe pajisje	2 500,00	-	2 500,00	-	-
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	7 000,00	900,00	6 100,00	12,86	1 200,00
3	Material i zyrës	4 375,00	562,38	3 812,62	12,85	1 315,84
4	Material sanitar	1 750,00	-	1 750,00	-	428,96
5	Qiraja për objektet	3 750,00	1 940,10	1 809,90	51,74	1 547,14

6	Reprezentacioni dhe bufeja	1 000,00	138,25	861,75	13,83	949,19
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	1 175,00	41,00	1 134,00	41,00	-
8	Shpenzimet logjistike	5 000,00	637,22	4 362,78	12,74	548,95
9	Kontigjente	2 500,00	-	2 500,00	-	-
	TOTAL - Shpenzimet administrative	29 050,00	4 218,95	24 831,05	14,52	5 990,08
	Provizionimi i llogarive të arkëtueshme	-	-	-	-	-
II	TOTAL - SHPENZIMET (B+C+D+E)	723 000,00	360 847,80	362 152,20	49,91	489 120,44
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	56 068,75	51 185,94	4 882,81	91,29	(62 409,22)
	GRANTET	102 500,00	120 939,12	(18 439,12)	117,99	77 488,86
F	Shpenzimet e zhvlerësimit		-			
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	72 500,00	120 939,12	(48 439,12)	166,81	77 488,86
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	30 000,00	13 380,96	16 619,04	44,60	13 409,98
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	102 500,00	134 320,08	(31 820,08)	131,04	90 898,84
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	26 068,75	37 804,98	(11 736,23)	145,02	(75 819,20)


Tabela Nr. 3.1

Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit Korrik – Shtator 2025



Diagrami Nr. 3.2

Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive Korrik – Shtator 2025



Diagrami Nr.3.3

III.2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 30.09.2025

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 30.09.2025
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	236,80
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0,00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	1,86
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	1,00
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	1,39
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	27,52
7	PCB nr. 1114-004229-0001-65	145 820,94
	TOTALI	146 061,99

Tabela Nr. 3.4

III.3. Transaksionet e realizuara Korrik – Shtator 2025

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse, llogarinë e projekteve kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe llogaritë rrjedhëse për subvencione:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.07.2025	4 941,85
Inkasimet e pranura gjatë muajve Korrik - Shtator 2025	704 907,41
Pagesat e kryera gjatë muajve Korrik - Shtator 2025	700 202,36
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.09.2025	236,80

Tabela Nr. 3.6

Transaksionet e kompanisë nga subvencionet (MI dhe ME) në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.07.2025	0,42
Inkasimet e pranura gjatë muajve Korrik - Shtator 2025	392 111,10
Pagesat e kryera gjatë muajve Korrik - Shtator 2025	392 101,70
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.09.2025	9,82

Tabela Nr. 3.7

Transaksionet e kompanisë Llogaria e kursimeve FLEX në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.07.2025	290 640,94
Inkasimet e pranura gjatë muajve Korrik - Shtator 2025	385 072,00
Pagesat e kryera gjatë muajve Korrik - Shtator 2025	529 892,00
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.09.2025	145 820,94

Tabela Nr. 3.8

Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës Korrik - Shtator 2025 për deponimet dhe pagesat:

Deponimet Korrik - Shtator 2025			Pagesat Korrik - Shtator 2025		
Nr.	Emërtimi	Vlera	Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Deponim nga ME/Kapitale	0,00	1	Pagesa per Pagat 2025	335 702,97
2	Deponim nga MMPHI	227 580,38	2	Pagesa per Hib Petrol	76 251,23
3	Deponim nga ME	127 704,07	3	Pagesa per Infracos	51 052,84
4	Deponim nga TU	21 325,00	4	Pagesa per Kontribute	27 462,94
5	Deponim nga G.C.F	1 000,00	5	Pagesa e Tatimit ne Page	13 584,60
6	Deponim nga KMDK	152,54	6	Pagese per Macedonia Railways	3 997,63
7	Deponim nga Llogaria FLEX	326,42	7	Pagese per Telekom i Kosoves sh.a - Mobil	2 766,19
8			8	Pagese per GETNO shpk	2 478,00
			9	Pagesa oer Link Insurance Broker	1 982,40
			10	Pagese per Komp. Mbet. Pastrimi Shpk	1 592,02
			11	Pagese per Planet Accounting LLC	1 500,00
			12	Pagese per UBT shpk	870,00
			13	Pagese per Europrint Group shpk	485,18
			14	Pagese per Telekom I Kosoves shpk - fiks	401,00
			15	Pagese per BM SolutionLLC	366,55
			16	Pagese per PM group	326,54
			17	Pagese per Lidra shpk	260,00
			18	Pagese per Instituti I mjeksise ligjore sh.a	150,00
			19	Pagese per SCAAK	80,00

		20	Pagese per tatim ne qera	51,00
		21	Shpenzimet e bankes	308,92
TOTALI		378 088,41	TOTALI	521 670,01

Tabela Nr. 3.8

III.4. Bilanci i Gjendjes (30.09.2025)

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A	GJENDJA FILLESTARE 01.01.2025	GJENDJA PERFUNDIMTARE 30.09.2025
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	2,242,734.25	1 851 307,95
Mjetet Qarkulluese	1,012,659.08	1 141 143,60
Stoqet	420,534.77	578 654,84
Paraja	528,003.53	146 096,94
Llogarite e arketueshme	51,179.71	395 644,34
Kerkesa tjera te arketushme	3,026.72	5 399,68
Parapagimet	9,914.35	15 347,80
Total Mjetet Qarkulluese dhe Themelore	3,255,393.33	2 992 451,55
Detyrimet afatshkurta	2,117,841.31	2 073 656,41
Llogarite e pagueshme	754,837.32	711 942,58
Te pagueshme tjera - detyrime	558.44	1 772,35
Detyrime tatimore	997,482.55	994 978,48
Detyrimet e kredisë	364,963.00	364 963,00
Detyrimet afatgjata	1,554,696.31	1 322 192,13
Kapitali	5,294,036.25	5 293 266,88
Fitimi/Humbja e bartur	-5,222,550.72	5 711 180,58
Fitim/ Humbja e vitit	-488,629.86	7134,91
Total detyrimet dhe kapitali	3,255,393.32	2 992 451,55

Tabela Nr. 3.9

IV.TRANSPORTI I UDHËTARËVE

IV.1 Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU

Gjatë periudhës Korrik – Shtator 2025 numri i përgjithshëm i udhëtarëve të transportuar është 23,519 ndërsa shuma e të hyrave nga shitja e biletave dhe ID kartelave është 24,469.00 me TVSH dhe 20.736.440 € pa TVSH. Krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2024, numri i udhëtarëve në TM3 2025 është për 8296 udhëtarë më shumë, shprehur në përqindje 54.50 %,më shumë. Krahasuar me planifikimin, numri i udhëtarëve të transportuar është për 1019 udhëtarë më shumë, shprehur në përqindje,+4.53%. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për 12,033.24 € më shumë, apo + 96.76 %, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për + 6,469 € më shumë, apo shprehur në përqindje + 35.94 %.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore performancën operative dhe financiare në transportin e udhëtarëve për periudhën **Korrik - Shtator 2025** si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar,dhe planifikimin për periudhën raportuese në TM3 2025:

Sqarim : në numrin total të udhëtarëve nuk janë të përfshira kategoritë e liruar nga pagesa,këto kategori nuk paguajnë biletë ,mirëpo janë kategori të cilat frekuentojnë mjaft shumë transportin hekurudhor.

Të dhënat për numrin e udhëtarëve për periudhën TM3 2025							
Përshkrimi	Realizim TM3 2024	Realizimi TM3 2025	Planifikim TM3 2025	Dallimi: Realizim TM3 2025 – TM3 2024	Dallimi: Realizim - planifikim TM3 2025	Dallimi në %: TM3 2025 – TM3 2024	Dallimi në %: Realizim - planifikim TM3 2025
Korrik - Shtator	15,223	23,519	22,500	+ 8,296	+1019	+54.50%	+4.53%

Tabela Nr. 4.1

Të dhënat për realizimin financiar në transportin e udhëtarëve për periudhën TM3 2025							
Përshkrimi	Realizimi TM3 2024	Realizimi TM3 2025	Planifikimi TM3 2025	Dallimi: Realizim TM3 2025 – TM3 2024	Dallimi: Realizim - planifikim TM3 2025	Dallimi në %: TM3 2025 – TM3 2024	Dallimi në %: Realizim - planifikim TM3 2025
Korrik-Shtator	12,435.76	24.469.00	18.000.00	+12.033.24	+6,469.00	+96.76%	+35.94%

Tabela Nr. 4.2

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura më sipër, gjatë kësaj periudhe kohore është shënuar një rritje në numrin e udhëtarëve krahasuar si me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ashtu edhe me planifikimin.

IV.2 Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km)

Numri i trenave të udhëtarëve për këtë periudhë tremujore gjithsej ka qenë 551 ndërsa numri i përgjithshëm i udhëtarëve për kilometër (udhëtar/kilometër) ka qenë 930,450.28 Sa i përket totalit të kilometrave të zhvilluara nga të gjithë trenat e transportit të udhëtarëve (tren/km) ka qenë 33,621.7

V/kom 38.08 km/h.

IV.3 Vonesat e trenave të udhëtarëve

Të dhëna përmbledhëse për vonesat e trenave (nga gjithsej 536 trena):

Shkaku i vonesave	Minuta	Në përqindje (%)
Lokomotiva HM	0	0
Vazhdimi i udhëtimit	0	0
Kryqëzimet	0	0
Lokomotiva/GM defekt	0	0
Lidhja me trenin	0	0
Bashkëngjitja e vagonëve/tërheqja e mjeteve	0	0
Doganë + Polici	0	0
Pritje në garniturë	0	0
Aksidente	0	0
Në nisje	1182	14.84%
Në arritje	6782	85.16%
Të tjera	0	0
Total vonesat	7964	100%

Tabela Nr. 4.3

V. TRANSPORTI I MALLRAVE

V.1 Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TM

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës operative në transportin e mallrave për periudhën korrik – shtator 2025 si dhe do të behët krahasimi me planifikimin dhe me realizimin për periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Gjatë periudhës korrik – shtator 2025 nuk është realizuar fare transport , po ashtu krahasuar me priudhën e njëjtë raportuse të vitit 2024 ,në TM-3 nuk ka pasur transport pra 0.00, neto-tonë mallra, ndërsa shuma e të hyrave nga ky transport ka qenë 0,00 €. Mirëpo ,nëse krahasojmë realizimin me planifikim periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2025, në TM-3 , nuk është realizuar asnjë transport,pra 0.00% e planifikimit ,ndërsa ne TM-3,2024 janë 0,00 neto ton mallra apo shprehur në përqindje nuk është realizuar fare transport 0,00% e planifikimit.Ndërsa realizimi financiar krahasuar me periudhen e njëjtë tëvitit të kaluar është 0.00€, apo shprehur në përqindje,0.00% ndërsa, krahasuar me planifikim janë -256,000.00 €, apo shprehur në pëqindje 0.00%,të realizimit financiar të parashikuar.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore dhe përmes diagrameve performancën operative dhe financiare në transportin e mallrave për periudhën korrik - shtator2025 si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar si dhe me planifikimin për periudhën raportuese në TM3 2025.

Realizimi në transportin e mallrave:

Korrik - Shtator2025	Realizimi Neto Ton 2024	Realizimi Neto Ton 2025	Planifikimi Neto Ton 2025	Dallimi Realizim 2025/2024	Dallimi Realizim-Planifikim 2025	Dallimi Realizim 2025/2024 (%)	Dallimi Realizim-Planifikim 2025(%)
Sasia e transportuar	0.00	0.00	110,000	0.00	-110,000	0.00%	0.00%

Tabela 5.1

Siç mund të shihet nga tabela 5.1, transporti nuk është realizuar 0.00% të planifikimit.

Transporti i mallrave me kontejnerë për periudhën Korrik – Shtator 2025 ka qenë:

Numri i transportuar i kontejnerëve	Kontejnerë të plotë 2025	Kontejnerë të zbrazët 2025
Sasia	0.00	0.00

Tabela 5.2

Sasia e transportuar në neto-ton për periudhën Korrik - Shtator 2025 në formë diagrami:




Figura 5.1

Siç mund të shihet nga figura 5.1 në aspektin operativ nuk kemi arritur të realizojmë transportin e planifikuar për periudhën Korrik - Shtator 2025.

Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Të hyrat Korrik - Shtator 2025	Realizim shitje të hyra 2024	Realizim shitje të hyra 2025	Planifikim 2025	Dallimi në Realizim 2025/2024	Realizim-Planifikim 2024	Realizim 2025/2024 (%)	Realizim-Planifikim 2025 (%)
Vlera €	0.00	0.00	256,000.00	0.00	-256,000.00	0.00%	0.00%

Tabela 5.3

Siç mund të shihet nga tabela më lart, të hyra nuk kemi pasur,nuk kemi arritur të realizojmë transportin e planifikuar për periudhën Korrik - Shtator 2025.

Të hyrat në periudhën Korrik - Shtator 2025 në formë diagrami:




Figura 5.2

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave:

Të hyrat dhe shpenzimet	Shitjet/të hyrat në TM	Të ardhura tjera nga TM	Total shitjet	Shpenzim et direkte në TM	Shpenzi met indirekte në TM	Total Shpenzim et	Fitimi/hu mbja operative	Fitimi/humbja në %
Vlera €	0.00	357.40	357.40	67,786.73	2,333.00	70,119.73	(69,762.33)	-195.19

Tabela 5.4

Transporti i Mallrave në kostot indirekte ka marrë 6.97% të shpenzimeve në total të kompanisë kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve me transportin e udhëtarëve në bazë të përqindjes së marrjes pjesë me trena (*tren kilometër*) në komunikacion.

V.2 Shfrytëzimi i trenave

Për shkak të punimeve në Linjën e 10-të Hekurudhore, në relacionin Fushë Kosovë - Hani i Elezit, linja ka qenë e mbyllur gjatë gjithë kohës, Ndërsa, transporti vendor nuk është realizuar sipas planifikimeve, për shkak të mos fillimit të transportit të xehes nga Ferronikeli.

Korrik – Shtator 2025	Trena të planifikuar	Trena të shfrytëzuar	Shfrytëzim/Planifikim në % 2025
Import	0	0	0.00 %
Export	0	0	0.00 %
Vendor	228	0	0.00 %
Total	228	0	0.00 %

Tabela 5.5

V.3 Efektiviteti i trenave

Korrik –Shtator- 2025	Pesha max. Bartëse t/tren	Mesatarja e çdo treni – bt	Efektiviteti (%)
Import	1200	0.00	0.00 %
Eksport	1200	0.00	0.00 %
Vendor	1400	0.00	0.00 %

Tabela 5.6

V.4 Neto-ton & neto-ton kilometër të transportuar

Neto ton	Realizim Korrik–Shtator 2025	Planifikim Korrik–Shtator 2025	Realizim/Planifikim 2025 në %	Neto ton kilometër	Humbje Planifikim/Realizim 2025 (ton)
Import	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00
Export	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00
Vendor	0	110,000	0.00 %	0.00	-110,000
Total	0	110,000	0.00 %	0.00	-110,000

Tabela 5.7

Organizimi i tërheqjes me lokomotiva dhe manovruese – shpenzimet e naftës dhe kilometrat e kaluara

Shpenzimet e lokomotivave tërheqëse dhe manovruese -Transporti i mallrave Korrik -Shtator 2025							
Muaji	Shp/km	2640-007	2640-008	2710-009	2640-010	2760-001	Totali
Korrik	Shp.Naftë	1,500	1,700	1,200	0.00	0.00	4,400
	Kilometrat	13	528	555	0.00	10	1,106
	Nafta /km	0.00	3.22	2.16	0.00	0.00	3,978
Gusht	Shp.Naftë	0.00	1,000	0.00	0,00	0.00	1,000
	Kilometrat	0.00	1,155	0.00	0.00	0.00	1,155
	Nafta /km	0.00	0.87	0.00	0.00	0.00	0.87
Shtator	Shp.Naftë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Kilometrat	32	140	0.00	0.00	0.00	172
	Nafta /km	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Korrik-Shtator-2025	Shp.Naftë	1,500	2,700	1,200	0.00	0.00	5,400
	Kilometrat	45	1,823	555	0.00	10	2,433
	Nafta /km	0.00	1.481	2.162	0.00	0.00	2,219

Tabela 5.8

V.5 Revokimi i trenave

Gjatë periudhës Korrik – Shtator 2025 ka pasur revokime të trenave të planifikuar, të cilat pasqyrohen në tabelën në vijim sipas kategorive të ndara në transportin ndërkombëtar (import-export) dhe transport vendor:

Korrik - Shtator 2025	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import-Export	78	0	0	0	0.00 €
Vendor	152	76	0	0	0.00 €
Total	230	76	0	0	333.26 €

Tabela 5.9

VI. MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE -MML

VI.1 Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën gjatë periudhës 01 Korrik – 30 Shtator 2025, duke krahasuar me realizimin e tre mujorin të dytë (TM3) të vitit 2024.

VI.2 Sektori i mirëmbajtjes

Në Zyrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse përfshihen: Mirëmbajtja e trenave motorik, mirëmbajtja e lokomotivave transportuese, mirëmbajtja e lokomotivave manovruese, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave dhe punë të tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

VI.3 Mirëmbajtja e trenave motorik

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorik të realizuara ne periudhën Korrik- Shtator 2025 krahasuar me periudhën Korrik- Shtator 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Korrik - Shtator 2025	Korrik – Shtator 2025	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	0	0	0
3.	Kontrollime K1	0	0	0
4.	Kontrollime K6	0	0	0

Tabela 6.1

VI.4 Mirëmbajtja e Lokomotivave Transportuese

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Korrik-Shtator 2025	Korrik-Shtator 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	91	110	-19
2.	Riparime	11	19	-8
3.	Kontrollime K1	6	9	-4
4.	Kontrollime K3	0	2	-2
5.	Kontrollime K6	4	3	+1
6.	Gdhendja e rrotave	1	3	-2

Tabela 6.2

VI.5 Mirëmbajtja e Lokomotivave Manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në periudhën Korrik- Shtator 2025 krahasuar me periudhën Korrik- Shtator 2024:

	Lloji i Riparimit/Mirëmbajtjes	Korrik - Shtator 2025	Korrik - Shtator 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	1	5	-4
3.	Kontrollime K1	1	0	+1
4.	Kontrollime K3	0	0	0
5.	Kontrollime K6	1	0	1

Tabela 6.3

VI.6 Intervenimet në mjetet tërheqëse

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë periudhës tre mujore (Korrik – Shtator 2025) për secilin mjet tërheqës është dhënë në tabelën në vazhdim:

Mjetet tërheqëse (Nr.)	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime (S)	81	2	4	3	0	1	0	0	0
Riparime (R)	2	2	1	3	1	2	1	0	0
Kontrollime (K 1)	2	1	2	0	0	1	1	0	0
Kontrollime (K 3)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kontrollime (K 6)	1	1	1	1	0	0	1	0	0
Gdhendje të rrotave	1	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 6.4

Servisime – S

Riparime – R

Kontrollime njëmuajor – K1

Kontrollime tremujor – K3

Kontrollime gjashtëmuajor – K6

VI.7 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtareve realizuar në periudhën Korrik- Shtator 2025, krahasuar me periudhën Korrik- Shtator 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Korrik-Shtator 2025	Korrik-Shtator 2024	Ndryshimi
1.	Kontrollime (K1)	9	12	-3
2.	Riparim në punëtori	12	16	-4
3.	Gdhendje të rrotave	1	1	0
4.	Testim i komponentëve	0	0	0
5.	Riparime në stacion	0	0	0

Tabela 6.5

IV.8 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuar në periudhën Prill- Qershor 2025, krahasuar me periudhën Prill- Qershor 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Korrik-Shtator 2025	Korrik-Shtator 2024	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	0	0	0
2.	Riparim në punëtori	0	0	0
3.	Riparim në teren	0	0	0
4.	Gdhendje të rrotave	0	0	0

Tabela 6.6

VI.9 Riparimi i vagonëve të huaj

Gjatë këtij tre mujori, Zyra e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse nuk ka pasur kërkesa për riparim të vagonëve të huaj.

Në tabelën nr.6.7, janë paraqitur vlerat e punëve të kryera për periodën Prill- Qershor 2025 dhe është krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024:

Riparimi/mirëmbajtja e vagonëve të huaj	Korrik - Shtator 2025	Korrik – Shtator 2024
NewCo Ferronikeli	00.00 €	00.00 €

Tabela 6.7

VII. PROJEKTET DHE PROKURIMI

VII.1 Projektet Kapitale

Projektet e tenderuara me procedura sipas kërkesave të LPP-se të bazuara në vlera të zotimit:

Nr.	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat.	Koment
1	Shërbimet e abonimit të arkave fiskale	4,319.98	4,319.98	Në implementim
2	Shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit financiar PLANET Accounting	10,800.00	10,800.00	Ne implementim
3	Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025	9,500.00	7,839.97	Në implementim
4	Furnizimi me modul kontrolle për diesel motor të tipit 8-710G3B-2	12,000.00	9,971.00	Kontraktuar
5	Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva)	16,000.00	15,147.36	Në implementim
6	Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezerve për MML II (Furnizimi me xhama për vagonë të udhëtareve)	14,000.00	13,196.47	Përfunduar
7	Furnizimi me modul për lokomotivën G1700	6,500.00	6,485.28	Kontraktuar
8	Furnizim me modul TH14 për lokomotivën GM 645	7,500.00	4,472.20	Përfunduar
9	Furnizimi me laptop për nevoja të Bordit të Drejtoreve të Trainkos Sha	2,400.00	1,090.00	Përfunduar
10	Riparimi i frenueseve indirekte Westinghouse 26C për lokomotivën GM G16 (661)	6,500.00	6,431.00	Kontraktuar
11	Furnizimi me material Higjienik	5,000.00	1,482.73	Në procedurë

12	Furnizimi me brusha për lokomotivën 645	3,800.00	2,478.00	Përfunduar
13	Furnizimi me materiale administrative	3,300.00	2,444.02	Kontraktuar
14	Furnizimi me toner për nevoja te Trainkos Sha	1,400.00	1,299.01	Kontraktuar
15	Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve	365,420.00		Anuluar
16	Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 016	100,000.00	97.309.51	Kontraktuar
17	Rregullimi i Automjetit Hyundai X35	850.00	916.00	Kontraktuar
18	Furnizimi me fshesë elektrike për pastrimin e vagonëve	500.00		Anuluar
19	Furnizimi me injektor për motor 645 E3 te lokomotivave GT22HW-2	7,000.00	6,159.60	Përfunduar
20	Shërbimet e sigurimit të palëve të treta	2,000.00	1,982.40	Kontraktuar
21	Furnizim me klime 18 she	650.00	650.00	Kontraktuar
22	Furnizimi me printer skaner 4ne1	260.00	260.00	Kontraktuar
23	Furnizimi me ujë të pijshëm në bidon 10 L	990.00	900.00	Kontraktuar
24	Matja e Kënaqshmërisë së Klientëve në Transportin e Mallrave dhe të Udhëtarëve	870.00	844.00	Kontraktuar
25	Shërbimet e mirëmbajtjes se domenit dhe hostit për vitin 2025	500.00		Anuluar
26	Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML. Furnizimi me çelësa specialë për demontimin dhe montimin e kokave të lokomotivave të tipit 661 dhe 645.	6,500.00	6,018.00	Kontraktuar

27	Mirëmbajtja e Infrastrukturës kryesore të IT-së	24,000.00	23,998.36	Kontraktuar
28	Furnizimi dhe Riparimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML, Lot1 Furnizimi me siguresa stratuese per lokomotiva 400Am x25 V. Lot 2, Furnzimi me kontktor te kyeqjes	3,800.00		Anuluar
29	Shërbimet e mirëmbajtjes se domenit dhe hostit për vitin 2025	500.00	500.00	Kontraktuar
30	Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 2620-005	100,000.00		Anuluar
31	Furnizimi dhe instalimi i gjeneratorit statik me kapacitet 150 kW	17,000.00		Në pezullim
32	Investim ne asetë Kapitale-Transport specifik i 5 vagonëve të udhëtarëve (me makineri të rëndë)	64,036.00		Ritenderim
33	Furnizimi me bateri startuese plumbi për lokomotiva.	30,000.00		Në vlerësim
34	Furnizimi me bateri për vagonë të transportit të udhëtarëve	26,000.00		Njoftimi për kontratë
35	Furnizimi me rroba dhe mjete mbrojtëse për punëtorë	24,000.00		Njoftimi për kontratë

1. **Shërbimet e abonimit te arkave fiskale** - projekti është kontraktuar dhe është në zbatim.
2. **Shërbimet e mirëmbajtjes se sistemit financiar PLANET Accounting-** është nënshkruar kontrata më datën 10.01.2024 dhe është projekt për 3 vite, është procedurë e negociuar pa publikim.
3. **Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025** - Projekti është kontraktuar për periudhë tre vjeçare dhe është në zbatim e sipër. Operatori Ekonomik ka përfunduar pjesën e dytë të kontratës për auditim të pasqyrave financiare për vitin 2024 dhe e njëjta është faturuar.
4. **Furnizimi me modul kontrolle për diesel motor te tipit 8-710G3B-2** - kemi pranuar dy oferta dhe jeni ne fazën e kontraktimit me operatorin TOREX GROUP L.L.C.

5. **Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva)**- është dërguar edhe shuma e fundit për pagesë dhe janë bërë ndalesat administrative për vonesa nga operatori E.K.
6. **Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML II (Furnizimi me xhama për vagonë të udhëtarëve)**- projekti ka përfunduar dhe është pranuar fatura dhe është dërguar për pagesë.
7. **Furnizimi me modul për lokomotivën G1700**- projekti është përsëritur dhe kemi nënshkruar kontratën me O.E Profitech SH.P.K.
8. **Furnizim me modul TH14 për lokomotivën GM 645** – është pranuar nga komisioni teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.
9. **Furnizimi me laptop për nevoja të Bordit të Drejtoreshave të Trainkos Sha** – është pranuar nga komisioni teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.
10. **Riparimi i frenueseve indirekte Westinghouse 26C për lokomotivën GM G16 (661)**- është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik RM In Time L.L.C. me çmim 6,431.00 €.
11. **Furnizimi me material Higjienik** - është shpallur oferta fituese me të cilën është nënshkruar kontrata me O.E. PM GROUP SH.P.K. me çmim 1,482.73 €.
12. **Furnizimi me brusha për lokomotivën 645** – është bërë hapja e tenderit kemi pranuar 8 oferta, komisioni i vlerësimit ka marr ofertat për vlerësim. Eshte nënshkruar kontrate me O.E. GETNO L.L.C. ne vlerë 2,478.00 €, projekti ka përfunduar pasi është bërë liferimi i mallit sipas afateve, është shkruar për pagesë.
13. **Furnizimi me materiale administrative** - është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik me vlere prej 2,444.02 €.
14. **Furnizimi me toner për nevoja te Trainkos Sha** - është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik me vlere 1,299.01 €.
15. **Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve** - është bërë anulimi i tenderit.
16. **Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 016** – është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik Profitech me vlere prej 97,309.51 €.
17. **Rregullimi i Automjetit Hyundai X35** - është bërë hapja e tenderit dhe kemi pranuar një oferte nga NTP Auto Bosch me çmim prej 916.00 €. Projekti ka përfunduar.
18. **Furnizimi me fshesë elektrike për pastrimin e vagonëve** – ky projekt është tenderuar dy herë dhe nuk kemi pranuar asnjë ofertë.
19. **Furnizimi me injektor për motor 645 E3 te lokomotivave GT22HW-2** - projekti është pranuar nga komisioni i pranimit teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.
20. **Shërbimet e sigurimit të palëve të treta** është nënshkruar kontrata me O.E.
21. **Furnizim me klime 18-she**- kemi pranuar një ofertë dhe e njëjta është shpallur fituese.
22. **Furnizimi me printer skaner 4ne1** - projekti ka përfunduar fatura është dërguar për pagesë.
23. **Furnizimi me ujë të pijshëm në bidon 10 L** – kemi pranuar një ofertë nga Ujë Rogove Sh.P.K., dhe e kemi shpallur fitues, çmimi për bidon është 1.5 €.
24. **Matja e Kënaqshmërisë së Klientëve në Transportin e Mallrave dhe të Udhëtarëve** – kemi pranuar dy ofertues, dhe kemi shpallur fitues ofertuesin UBT me çmim 844.00 €.

25. **Shërbimet e mirëmbajtjes së domenit dhe hostit për vitin 2025** – nuk kemi pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme.
26. **Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML. Furnizimi me çelësa special për demontimin dhe montimin e kokave të lokomotivave të tipit 661 dhe 645.** – kemi bërë hapjen e ofertave dhe kemi pranuar një ofertë dhe është në vlerësim.
27. **Mirëmbajtja e infrastrukturës kryesore të IT-së,** më datën 08.08.2025 është bërë njoftimi për kontratë dhe hapja do të bëhet më datën 03.09.2025.
28. **Furnizimi dhe Riparimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML, Lot1 Furnizimi me siguresa stresuese për lokomotiva 400Am x25 V. Lot 2, Furnizimi me kontaktor te kyeqjes** më datën 28.08.2025 është bërë njoftimi për kontratë. Hapja e ofertave do të bëhet më datën 05.09.2025.
29. **Shërbimet e mirëmbajtjes se domenit dhe hostit për vitin 2025,** është bërë shpallja e tenderit më datën 03.09.2025.
30. **Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 2620-005,** hapja e tenderit është bërë më datën 26.09.2025 dhe kemi pranuar një ofertë me vlerë prej 108,344.40 €, e njëjta ka shkuar në vlerësim dhe është anuluar.
31. **Furnizimi dhe instalimi i gjeneratorit statik me kapacitet 150 kW,** hapja e tenderit është bërë më datën 01.10.2025 dhe kemi pranuar 4 oferta, është zgjedhur oferta më e lire me çmimin 11,870.80 €, lënda është në pezullim për shkak të ankesave të operatorëve të tjerë.
32. **Investim ne asete Kapitale-Transport specifik i 5 vagonëve të udhëtarëve (me makineri të rëndë),** kemi bërë njoftimin për kontratë më datën 17.09.2025, hapja e tenderit është bërë më datën 03.10.2025 dhe kemi pranuar një ofertë në vlerën prej 99,769.00 €, e cila është anuluar për shkak të tejkalimit substancial 55% mbi vlerën e parashikuar, e njëjta është ritenderuar më datën 06.10.2025 dhe do të bëhet hapja e tenderit më datën 24.10.2025.
33. **Furnizimi me bateri startuese plumbi për lokomotiva.,** njoftimi për kontratë është bërë më datën 19.09.2025, hapja e tenderit është bërë më datën 10.10.2025 dhe kemi pranuar 3 oferta të cilat janë në vlerësim.
34. **Furnizimi me bateri për vagonë të transportit të udhëtarëve,** njoftimi për kontratë është bërë më datën 30.09.2025, hapja e tenderit do të bëhet më datën 21.10.2025.
35. **Furnizimi me rroba dhe mjete mbrojtëse për punëtorë,** njoftimi për kontratë është bërë më datën 02.10.2025, hapja e tenderit do të bëhet më datën 23.10.2025.

VIII. KONTESTET LIGJORE

Gjatë periudhës kohore Korrik– Shtator 2025, nga zyra ligjore e ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë tre mujorit të tretë të vitit 2025, pranë Gjykatave Themelore dhe Komerciale ka qenë e caktuar 1 seancë gjyqësore për proceset në të cilat kemi qenë palë në procedurë qoftë në cilësinë e të paditurës apo të paditëses.

Gjatë tre mujorit të tretë të këtij viti ndërmarrja në procedurë gjyqësore është përballur dhe ka zhvilluar veprime procedurale në 3 konteste për kompensim dëmi, 2 konteste pune, 1 lëndë përmbartimore dhe 1 lëndë me procedurë penale 1 lëndë me aktgjykim ku refuzohet e pa themelt ankesa e të paditurës Trainkos Sh.A., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë vërtetohet , 1 lëndë me Aktgjykim të Gjykatës Themelore në Pejë ku refuzohet në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe lënda është në favor të Kompanisë Trainkos Sh.A., 1 lëndë me Aktvendim nga Gjykata Themelore në Fushë Kosovë refuzohet në tërësi propozimi i paditësve-propozuesve të sigurimit dhe lënda është në favor të Kompanisë Trainkos Sh.A, kemi pranuar një Ankesë nga Avokati i të autorizuarit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, kemi pranuar një konkluzion për ekspert financiar, 1 lëndë me Aktgjykim nga Gjykata e Apelit e Kosovës Aprovohet pjesërisht e themeltë ankesa e të paditësve, kemi pranuar një Urgjencë e të autorizuarit të paditësve, 1 lëndë me Aktvendim nga Gjykata e Apelit në Prishtinë ku Aprovohet si e themeltë ankesa e propozuesit Trainkos Sh.A.dhe prishet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjatë kësaj periudhe kemi dërguar Prapësim kundër Urdhërit Përmbartimor, kemi dërguar revizion në Gjykatën Themelore ë Pejë për Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë.

VIII.1 KONTESTET GJYQËSORE PËR VITIN 2025

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A. në vitin 2025, pritet të ballafaqohen me **61** konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të zhvillohen veprime procedurale te përshkruar sipas aktivitetit ne tabelën e mësipërme:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	
1.	Kontestet e marrëdhënies së punës	12
2.	Kontestet për kompensim të dëmit	24
3.	Kontestet për pagimin e borxhit	4
4.	Kontest nga Konflikti Administrativ	1
5.	Lëndë në procedurë përmbaremore	19
6.	Lëndë në procedurë penale	1
7.	Totali	61

IX. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

IX.1 Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Përkundër vazhdimësisë në realizimin e të hyrave nga Marrëveshja e OShP-së (2023 – 2027) për vitin 2025, transporti i planifikuar nga shërbimet për mallra nuk ka ndodhur. Edhe për këtë periudhë ashtu si në pjesën e fundvitit 2024 janë vonesat e përfundimit të punëve që janë duke u zhvilluar në modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore. Nëse e kemi parasysh se Linja e 10-të hekurudhore është arteria bazë e rrjetit hekurudhorë në dhe nga Kosova atëherë kjo është pengesë esenciale në zhvillimin e biznesit të kompanisë për transport me hekurudhë dhe realizimin e projekteve tjera po ashtu shumë esenciale për të ardhmen. Pritjet tona që Linja të lëshohet në shfrytëzim sipas orareve të paralajmëruara nuk kanë ndodhur, nga kjo vazhdon mosplotësimi i planifikimeve tona për transportin e mallrave dhe udhëtarëve sipas planifikimeve dhe kërkesave që dalin për sektorin hekurudhor nga planifikimet dhe strategjitë e shtetit të Kosovës.

IX.2 Aktivitetet në transportin e mallrave përgjatë periudhës Korrik – Shtator 2025

Nga klientët vendorë, me të cilët kemi pasur të nënshkruar aneks kontratë për transport deri më 31.12.2023 ka qenë vetëm një, klienti nuk ka vazhduar kontratën gjatë vitit 2025:

Nr.	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NewCo Ferronikeli	Drenas	Xehe të nikelit dhe thëngjill.

*Klientët/Partnerët të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Trainkos Sh.A. për vitin 2025 janë gjithsej tre (3) partnerë. Duhet theksuar se këta partnerë që kanë nënshkruar kontratë transporti janë ndërkombëtarë, të njëjtit kanë pasur kontratë të nënshkruar edhe në vitin 2024, përjashtimisht klienti/partneri **Schenker DB dhe Fershped AD.***

Lista e partnerëve ndërkombëtarë:

Nr	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NAVICO SHIPPING DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
2	CARGO LOGISTC DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
3	ARGO LOGISTIC INT	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet

IX.3 Aktivitetet në fushën promovuese gjatë periudhës Korrik – Shtator 2025

Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura Sektori i Marketingut kryen edhe aktivitete të tjera në fushën promovuese dhe menaxhon buxhetin e shpenzimeve të Sektorit të Marketingut për promovimin e shërbimeve të Trainkos Sh.A. përmes kanaleve të ndryshme të marketingut. Sektori i Marketingut ka qenë gjithmonë në përcjellje të organizimeve grupore të cilat janë aprovuar dhe janë realizuar me vagonë të udhëtarëve, nëpërmjet kërkesave të veçanta për shfrytëzimin e aseteve të Trainkos Sh.A. Po ashtu, gjatë tërë kohës mbajmë kontakte me udhëtar aktual dhe potencial të cilët bëjnë pyetje nëpër rrjetet sociale.

Kërkesat që kemi pasur për shfrytëzim të aseteve, shërbimeve të veçanta gjatë periudhës Korrik – Shtator 2025 janë si në vijim:

Nr.	Data e shfrytëzimit	Institucioni	Lloji i Shfrytëzimit
1	21.09.2025-25.09.2025	Sidirodroumeas-a You Tube Railway Channel	Video dhe fotografi ne tren dhe ne stacione te trenave
2	27.09.2025	Dardan Visuals	Xhirime për videoklip muzikor
3	25.09.2025	SHFMU “Mitrush Kuteli”Prishtinë	Shëtitje me tren
4	30.09.2025	Telegrafi	Xhirime për emision

IX.4 Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera

Vazhdon të mbetet pengesë gjendja aktuale e linjave hekurudhore brenda vendit dhe lidhja me hekurudhat e shteteve në regjion për zhvillimin e biznesit të ndërmarrjes. Vonesat në përfundimin e projekteve për modernizimin e linjave hekurudhore pamundëson edhe shfrytëzimin e potencialit nga Portet Detare dhe Linjave tjera hekurudhore që mundësojnë transportin me hekurudhë me pjesën tjetër të Evropës dhe Botës. Kjo argumenton urgjencën e nevojës për modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore për të treguar një vazhdimësi në transportin hekurudhorë brenda dhe jashtë vendit. Koordinimi i proceseve dhe përfundimi i projekteve të filluara infrastrukture mundëson vazhdimin e realizimit të projekteve tjera sipas prioriteteve të përcaktuara dhe mundësive financiare që krijohen.

Për transportin e Lokomotivës Ambasadore Di3.619 në Augsburg (Gjermani) janë marrë veprimet e nevojshme të kërkuara nga përgjegjësit e organizimit të transportit. Konkretisht me përfaqësuesin e muzeut Z. Krammer që ju ka dhënë përgjigja në kërkesën e tij. Për këtë qëllim, është përgatitur një draft fillestar i formës së autorizimit nga ana jonë. Ky dokument do të shqyrtohet nga Z. Godanci dhe, pas dakordimit, të nënshkruhet në një takim me z. Godanci dhe

përfaqësuesit përgjegjës të TRAINKOS-it, ose në një formë tjetër paraprakisht të rënë dakord. Priten veprime konkrete dhe më në fund të bëhet transportimi i Lokomotivës në destinacionin final.

IX.5 Pjesëmarrja e Trainkos-it në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhor përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme

Në muajin Shtator 2025 Shoqata AES, në bashkëpunim me UP dhe UPT, ka organizuar Kongresin ICME në Prishtinë më 10 dhe 11 Shtator, në ambientet e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të UP-së. Në këtë kongres janë trajtuar tema të shumta akademike, por edhe çështje aktuale industriale dhe infrastrukturore, që lidhen si me zhvillimet evropiane ashtu edhe me ato vendore. Ditën e parë të Kongresit (e enjte, datë 10.09.2025) në kuadër të sesionit mbi transportin, janë prezantuar disa tema mbi transportin hekurudhor. Konkretisht ditën e parë janë prezantuar dhe diskutuar të arriturat e kohës në teknologji informative, riciklim, energji, transport ,etj. Rëndësi e veçantë ju ka kushtua edhe transportit hekurudhorë si alternativë e preferuar edhe në Evropë për shkak të përfitimeve që ka. Ditën e dytë ka pas edhe prezantime specifike vetëm për hekurudhë, janë përfshi edhe bazat e sistemit të sinjalizimit hekurudhor ETCS si pjesë e ERTMS dhe parakusht për të arritur hapin e transportit modern të imponuar nga BE. Një temë interesante ka qenë “Mobiliteti si shërbim (MaaS) si tërësi duke e përfshirë edhe shërbimin te transporti hekurudhorë për njerëzit me aftësi të kufizuara. Kongresi ka specialist të fushave të ndryshme që kanë pas për qëllim prezantimet në fusha specifike të përmendura dhe nxitjen për mobilizim të të gjithë akterëve përgjegjës në Kosovë për veprim.

IX.6 Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante për proceset që ndërlidhen me këto entitete

Vazhdojnë angazhimet përhershme në plotësimin e obligimeve ligjore në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport, Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH), Ministrinë e Ekonomisë (ME), Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA). Ndër aktivitetet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese vlen të veçohen:

- Në bazë të kërkesës rutinore vjetore kemi pranuar kërkesën nga ARH për rishikimin e listës së Marrëveshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare të ndodhura brenda vitit. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shqyrtimit të listës është kompletuar përgjigja dhe kthyer tek përgjegjësit e ARH-së;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës ka bërë kërkesën për plotësimin e indikatorëve që i përkasin TRAINKOS-it në detyrën e përgatitjes së të dhënave për vitin 2023 dhe 2024. Këto të dhëna të përbashkëta do të përcillen tek Eurostat sipas marrëveshjes dhe obligimeve që ka shteti ynë ndaj Eurostat-it. Afati i plotësimit të të dhënave ka qenë 15 Shtatori 2025;
- Mbetet si obligim dhe imperativ procedurat dhe obligimet që Ndërmarrja duhet të i përcjellë për futjen në funksion të pesë vagonëve të udhëtarëve pas finalizimit të procesit riparimi i mesëm. Pasi që të njëjtit aktualisht janë në Han të Elezit, obligim i radhës i

TRAINKOS-it është që zyrtarisht të njoftoj ARH-në kohë e futjes në qarkullim. Natyrisht kjo kur të dihet pasi që aktualisht situata e krijuar me mbylljen e Linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit e pamundëson këtë;

- Sipas kërkesës dhe nevojës për të i konfirmuar statistikat për transport me hekurudhë që do të përfshihen në të dhënat që dërgohen në EUROSTAT janë punuar, konfirmuar dhe dërguar tek përgjegjësit në ESK;
- Janë përgatitur dhe dorëzuar raportet e rregullta mujore për statistikat e transportit të realizuar nga TRAINKOS-i në ARH;
- Për nevojat e raportimeve dhe evidencave nga ARH është kërkuar konfirmimi i transportit të realizuar nga TRAINKOS për vitet 2022, 2023 dhe 2024. Të njëjtat janë analizuar, ri konfirmuar dhe dërguar me kohë sipas kërkesës;
- Janë kompletuar të dhënat (statistikat në baza mujore) sipas kërkesës së ASK dhe obligimeve ligjore për statistika në baza mujore për periudhën raportuese.

X.SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS KORRIK – SHTATOR 2025 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025, HK-Trainkos Sh.A. është përballur me një sërë sfidash që kanë ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin dhe performancën operationale të ndërmarrjes. Sfidat më të theksuara përfshijnë:

1. **Ndërprerjet në qarkullim** në linjën Fushë Kosovë – Hani i Elezit për shkak të vonesave në realizimin e projektit për modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore, që po zgjat më shumë se parashikimet fillestare.
2. **Mungesa e mjeteve lëvizëse** – me një flotë të vjetërsuar të lokomotivave dhe vagonëve, transporti i udhëtarëve vazhdon me trena klasikë në mungesë të trenave motorikë më efikasë dhe më ekonomikë.
3. **Kufizimet buxhetore**, që pengojnë investimet në rinovimin e flotës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për udhëtarët dhe mallrat.
4. **Pengesat ligjore dhe institucionale**, përfshirë mungesën e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor dhe boshllëqet në legjislacionin sekondar në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jolojale;
5. **Trashëgimi e rëndë juridike nga ish-Hekurudhat e Kosovës**, me procese gjyqësore të pazgjidhura që pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
6. **Mosfunksionimi i plotë i rrjetit hekurudhor vendor**, që kufizon zgjerimin e shërbimeve dhe ndikimin ekonomik të hekurudhës.
7. **Mungesë e kuadrit teknik profesional**, përballë një strukture të mbingarkuar me staf administrativ dhe moshë të lartë mesatare të personelit ekzistues.

Vetëm përmes një qasjeje të integruar dhe me mbështetje të qëndrueshme nga institucionet relevante, HK-Trainkos Sh.A. mund të rikthehet në rrugën e zhvillimit dhe të luajë një rol më të rëndësishëm në transportin kombëtar.

**Fushë Kosovë,
Korrik 2025**

